



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:065528

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00301062

P. nr.773/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit T. Sh. nga fsh. R.K-Gjakovë, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë PP.nr.1476/18 të dt.30.10.2018, në shqyrtimin e fillestar të mbajtur më datë **12.04.2019**, në prani të Prokurorit së shtetit Anton Hasanaj, perf. të autorizuar të dëmtuarës A. K. si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **T. SH.** nga fsh. R. K Gjakova, i biri i U. dhe i nënës F. e gjinisë J., data e lindjes . . ., ka të kryer vitin e 3-të të shkollës së mesëm, i pa punë –veteran i luftës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 4 fëmijëve, me nr.ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- **me datë të pavërtetuar e gjerë me dt.05.12.2016**, në shtëpinë e tij në fsh. R. K Gjakovë, me qëllim që vetes të sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. 62251762, përmes kabllor ka bërë lidhjen direkt në shtyllë përkatësisht në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollit, me ç' rast të dëmtuarës K.– Divizioni i Rrjetit –Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shume prej 304.46 euro,

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par 5,73, neni 320 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **20,00-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr. 1476/18 të dt.30.10.2018 ,e ka akuzuar të akuzuarin T. Sh. nga fsh. R.K-Gjakovë , për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni320 të KPRK-ës.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.12.04.2019 lexoi aktakuzën PP.nr.1476/18 të dt.30.10.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari T. Sh. ,gjatë shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët kompetent te K., ,shtojë se është penduar për këtë vepër penale të kryer për shkak te kushteve te dobëta ekonomike me qene se jam anëtari i vetëm i familjes i cili e mbaj familjen prej 7 anëtarëve me një pension te veteranit dhe se jam i pa punë edhe pse kompensimin e demit te dëmtuarës i ja kam bere ne tërësi me këste sipas marrëveshjes për çka edhe do te sjell transaksionin e konsumatorit te lëshuar nga e dëmtuara ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm ,andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm dhe nuk do te përsëris një veprim te tillë , gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Perf. i autorizuar i te dëmtares A. K. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit , ndërsa sa përket kompensimit te demit përmes parashtresës së dt. 12.04.2019, ka deklaruar se nga transaksionet e konsumatorit vërtetohet se i akuzuari ka bërë kompensimin e demit në tërësi andaj edhe nuk parashtrojmë kërkesë pasurore juridike..

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimit te fajësisë, nga vet pranimi i fajësisë është vërtetuar ne tërësi gjendja e plote dhe e drejtë faktike si ne dispozitivin e aktakuzës..

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari T. Sh. : **me datë të pavërtetuar e gjerë me dt.05.12.2016** , në shtëpinë e tij në fsh. R.K Gjakovë ,me qëllim që vetes ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim fitimi në mënyrë te paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike ,në atë mënyrë qe jashtë njehsorit elektrik me nr. 62251762, përmes kabllor ka bërë lidhjen direkt në shtyllë përkatësisht ne rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë se shpenzuar elektrike ,gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar te Distriktit ne Gjakovë me rastin e kontrollit ,me ç rast të dëmtuarës K.– Divizioni i Rrjetit –Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shume prej 304.46 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë

se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është baba i 7 fëmijëve , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim ,pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej veprat e tilla , kompensimi i dëmit në tërësi të dëmtuarës gjë që vërtetohet nga transaksionet e konsumatorit të lëshuar nga e dëmtuara e dt. 12.04.2019 s, gjendjen e dobët ekonomike si dhe fakti se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar e të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg ne kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë ne shumë prej **100 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike , ngase e dëmtuara K.-Divizioni i Rrjetit në Gjakovë gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.773/18 më datë 12.04.2019.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë.